



U D H Ë Z I M

PËR LLOGARITJEN DHE APLIKIMIN E RIV - IT

FUSHË KOSOVË

Mars 2015

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i HK TRAINKOS SH.A në Mbledhjen Nr. 52, të mbajtur më 13 dhe më 17.03.2015 miratoi këtë:

U D H Ë Z I M

PËR LLOGARITJEN DHE APLIKIMIN E RIV – IT

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Me këtë udhëzim rregullohet mënyra e llogaritjes dhe aplikimit të RIV-it për përdorimin e vagonëve të mallrave nga ana e H.K.Trainkos SH.A të cilët vagonë janë pronë e hekurudhave të tjera.

Neni 2

Llogaritja - Pagesa e RIV-it nga Hekurudhat tjera për Hekurudhat e Kosovës -Trainkos - SH.A.

Secili transportues hekurudhor është përgjegjës për mbajtjen e vagonëve të një transportuesi hekurudhor tjetër.

Transportuesi hekurudhorë që është anëtarë i UIC-it i cili ka dhënë në shfrytëzim në trafik hekurudhorë vagonët për ndonjë tjetër transportues hekurudhorë në rastin tonë Hekurudhat Maqedone ndaj Hekurudhave të Kosovës -Trainkos SH.A është i detyruar të dorëzojë faturën sipas modelit D (MUSTER D) në fund të çdo muaji, faturë e cila ka të bëjë me grupimin e vagonëve nga secili shtet, vagonët e të cilëve kanë hyrë në territorin e Kosovës për bartjen e mallrave. **(Adaptuar nga Kreu 3.5 RIV2000)**

Pas pranimit të Faturës, BP për kontrollin e të hyrave kontrollon dhe dorëzon për pagesë te Departamenti i Financave për procedurë të mëtutjeshme.

- Të gjitha faturat e kontrolluara dhe verifikuara të cilat janë në rregull duhet të dorëzohen për pagesë përveç rasteve kur BP për kontrollin e të hyrave has në gabime në llogaritje atëherë faturat kthehen mbrapa për korrigjime.

- Gjatë kontrollës së faturave BP për kontrollin e të hyrave duhet të ketë parasysh edhe kohën e shkyçjes së vagonit nga komunikacioni hekurudhorë për arsye të ndonjë dëmtimi dhe futjes në punëtori për riparim për të cilën kohë duhet të lirohen vagonët nga RIV-i.
- Formulari J (Muster J), plotësohet nga ana e H.K -Trainkos-SH.A me të cilën argumentohet koha e shkyçjes së vagonit nga komunikacioni deri në kthimin për atdhe. Ky formular iu dërgohet Hekurudhave Maqedone për secilin vagon të dëmtuar/riparuar.

Koha e llogaritjes së RIV – it bëhet për:

- ✓ Import – prej momentit të hyrjes së vagonëve në stacionet kufitare të H.K Trainkos-SH.A deri në momentin e daljes nga stacioni kufitar.
- ✓ Eksport - prej momentit të hyrjes së vagonëve në stacionet kufitare dhe vendosja për ngarkim deri në momentin e daljes nga stacioni kufitar.

Çmimorja e cila aplikohet për llogaritjen e RIV-it është e rregulluar nga UIC-I (Bashkësia ndërkombëtare e Hekurudhave) për secilin shtet anëtar.

Ne për vitin 2015 kemi marrë çmimoren nga Hekurudhat Maqedone të cilën do ta paraqesim me tabelën në vazhdim.

Tabela 1.

| Çmimi për grupin e vagonëve | Orët (euro/orë) | | |
|-----------------------------|-----------------|-------------------|-------------|
| | Prej 1 -240 orë | Prej 240 -720 orë | Mbi 720 orë |
| Vagonët 2- boshtorë | | | |
| 101 | 0.52 | 0.6 | 1.06 |
| 102 | 0.78 | 1.02 | 1.57 |
| 103 | 0.7 | 0.79 | 1.39 |
| 104 | 0.95 | 1.22 | 1.88 |
| 105 | 1.23 | 1.6 | 2.47 |
| Vagonët 4 - boshtorë | | | |
| 201 | 0.95 | 1.09 | 1.9 |
| 202 | 0.99 | 1.13 | 2 |
| 203 | 1.18 | 1.55 | 2.38 |
| 204 | 1.17 | 1.53 | 2.34 |
| 205 | 1.15 | 1.5 | 2.3 |
| 206 | 1.55 | 2.06 | 3.17 |
| 4955*/4956* | 2.22 | 2.91 | 4.46 |

Neni 3

Llogaritja - Pagesa e RIV-it nga Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A për Shfrytëzuesit e Transportit

HK – Trainkos - SH.A mënyrën e llogaritjes – kalkulimit të RIV-it ndaj organizatorit të transportit/shfrytëzuesit të transportit, të cilët transportojnë mallra me vagonë që janë pronë e hekurudhave të tjera e kalkulon në baza ditore ose me orë, varësisht prej kontratës së lidhur me klientë.

Llogaritja e RIV-it bëhet në bazë të Nenit 5 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve për kontratë dhe kushtet e transportit Nr. 02/324 të datës 29.12.2014.

- Në bazë të Nenit 5 HK - Trainkos Sh.A zbaton llogaritjen në shumën prej 15.50 € për vagon 2 boshtorë dhe 31.00 € për vagon 4 boshtorë për 24 orë.
- Në rastet kur aplikohet llogaritja e RIV-it me orë HK - Trainkos Sh.A zbatojnë llogaritjen në shumën prej 0.64 €/orë për vagon 2 boshtorë, si dhe 1.29 € /orë për vagon 4 boshtorë.

Çmimi 1.29 € rezulton nga pjesëtimi i shumës totale 31.00 €/24 orë = 1.29 € (çmimi i një orë)

Çmimi 0.64 € rezulton nga pjesëtimi i shumës totale 15.50 €/24 orë = 0.64 € (çmimi i një orë)

RIV llogaritet për:

- ✓ Import – prej momentit të hyrjes së vagonëve në stacionet kufitare të HK - Trainkos-it deri në momentin e shkarkimit.
- ✓ Eksport - prej momentit të hyrjes së vagonëve në stacionet kufitare dhe vendosja për ngarkim deri në momentin e zhdoganimit të tyre.
- ✓ Nëse vagonët mbesin për kohë më të gjatë se 10 ditë pa u shkarkuar - llogaritja e RIV-it do të zbatohet sipas çmimoreve të bazuar në Nenin 5 të Rregullores mbi përcaktimin e kriterëve për kontratë dhe kushtet e transportit Nr. 02/324 të datës 29.12.2014.

Neni 4

Trajtimi i Trenave Marshutë

Llogaritja - Pagesa e RIV-it

Transporti i dërgesave me tren marshutë, konsiderohet transporti më së paku 500,000 kg për një lloj malli të ngarkuar në më shumë vagonë për një klient dhe një stacion pritës.

Për vargun e vagonëve që i përkasin trenit Marshutë - llogaritja e RIV-it duhet të bëhet prej hyrjes së vagonëve në stacionin kufitar deri në momentin e shkarkimit për të gjithë vargun e vagonëve në të njëjtën kohë.

Neni 5

Lirimi nga Pagesa e RIV-it nga HK - Trainkos Sh.A për Shfrytëzuesit e Transportit

HK – Trainkos- SH.A do të bëjë lirimimin nga RIV- i për shfrytëzuesin e transportit në rastet kur:

- Klienti – shfrytëzuesi i transportit është i obliguar që HK - Trainkos-Sh.A t'i ofroj dëshminë se nga pronari i vagonëve – Hekurudhës përkatëse është i liruuar nga llogaritja e RIV – it.
- Këtë dëshmi Klienti e dërgon në HK – Trainkos- Sh.A, përmes postës elektronike ose postës së rëndomtë, (si për vagonë të plotë ashtu edhe të zbrazët).
- Lirimi nga llogaritja e RIV-it përfshin kohën e qëndrimit të vagonit prej momentit të hyrjes në stacionin kufitar deri në momentin e daljes nga stacioni kufitar.

HK – Trainkos- SH.A do të bëjë lirimimin nga RIV – i për shfrytëzuesin e transportit në rastet kur:

- Në rastet e pamundësisë së vendosjes së vagonëve në shkarkim – ngarkim në rastet kur ka mungesë të lokomotivave, në raste të jashtëzakonshme – mbyllje të linjave si dhe fatkeqësitë elementare.

Neni 6

Dispozitat përfundimtare

Më këtë udhëzim do të njoftohen: Sektori i Transportit të Mallrave, Njësia e Komerciales, Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit, Departamenti i Financave, Kalkulantet Miradi, Sektori i Marketingut.

Ky Udhëzim do të aplikohet pas miratimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi I Bordit të Drejtorëve dhe do të vlejë deri me shfuqizimin e tij.


Heset Cakolli
Kryesues i Bordit të HK-Trainkos - Sh.A